



Hamdi Mramori Street, No 1  
Prishtina 10000 – Kosovo  
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103  
Fax: +381 (0) 38 247 620  
e-mail: info@ero-ks.org  
www.ero-ks.org

## **RAPORTI RREGULLATIV**

**Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Gjakova SH.A.  
Sezoni i Ngrohjes 2007 - 2008**

**Prishtinë, 23 tetor 2007**

**RAPORTI RREGULLATIV**

**Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Gjakova SH.A.  
Sezoni i Ngrohjes 2007 - 2008**

**PËRMBAJTJA**

	<u>Faqe</u>
<b>1. Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore të Normës së Kthimit (RoR)</b>	<b>4</b>
<b>3. Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara</b>	<b>7</b>
<b>3.1 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Kostove Operacionale të Lejuara</b>	<b>8</b>
<b>3.2 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit</b>	<b>16</b>
<b>3.3 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Profiti i Lejuar)</b>	<b>17</b>
<b>3.3.1 Formimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)</b>	<b>17</b>
<b>3.3.2 Kalkulimi Normës së Lejuar të Kthimit në Bazën e Rregulluar të Aseteve për të gjitha ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore në Kosovë</b>	<b>19</b>
<b>3.3.3 Kalkulimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Profiti i lejuar) për NQ GJAKOVA</b>	<b>22</b>
<b>3.4 Kalkulimi i të Ardhurave të Lejuara para Bashkërenditjes</b>	<b>23</b>
<b>3.5 Bashkërenditja e të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2006-2007</b>	<b>23</b>
<b>3.6 Kalkulimi Final i të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008 përfshirë edhe bashkërendimin e sezonit të ngrohjes 2006-2007</b>	<b>23</b>

## RAPORTI RREGULLATIV

Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Gjakova SH.A.  
Sezoni i Ngrohjes 2007 - 2008

### PËRMBAJTJA (vazhdim)

<i>Figura 1 Skema për llogaritjen e të ardhurave të lejuara</i>	5
<i>Figura 2 Paraqitja skematike e kostove kryesore të propozuara nga NQ Gjakova dhe të pranura nga ZRrE-ja për sezonin e ngrohjes 2007/2008</i>	10
<i>Figura 3 Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Gjakova dhe lejuar nga ZRrE-ja për sezonin e Ngrohjes 2007/2008</i>	16
<i>Tabela 1 Kostot e paraqitura nga ana e NQ GJAKOVA, dhe ato të lejuara nga ana e ZRrE-së për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, e që përfshin gjithë sezonin e ngrohjes 2007 – 2008</i>	8
<i>Tabela 2 RAB për NQ GJAKOVA dhe komponentet e tij për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008</i>	19
<i>Tabela 3 Kthimi i Lejuar në RAB (Profit i lejuar) për NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008</i>	22
<i>Tabela 4 Të Ardhurat e Lejuara para Bashkërendimit për për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008</i>	23
<i>Tabela 5 Të Ardhurat e Lejuara për NQ GJAKOVA për sezonin e Ngrohjes 2007 – 2008</i>	24

## 1. Hyrje

Në pajtim me legjislacionin primar – Nenet 46, 47, 48 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tyre në sektorin e rregulluar të energjisë; këtu janë një sërë parimesh të gjera që kërkojnë rregulla jo diskriminuese dhe të arsyeshme me të cilat ndërmarrjet e energjisë do të mund t'i rikthenin të gjitha shpenzimet e arsyeshme përfshirë edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre.

Sektorin e ngrohjes qendrore në Kosovë në bartjen dhe shpërndarjen e ngrohjes është klasifikuar si monopol natyror, përderisa tash për tash akoma nuk ka konkurrencë për prodhimin e ngrohjes. Për këtë arsye, tarifat për ngrohjen qendrore duhet të aprovohen nga ZRRë-ja.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta legale, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Udhëzimin e Përkohshëm I\_05\_2007 mbi “Parimet e Llogaritjes së Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrhjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrhjes 2007/2008”. Udhëzimi përcakton procedurat për dorëzimin dhe aprovimin e tarifave dhe metodologjinë për llogaritjen e tarifave – Norma e Kthimit (RoR) – kjo është e bazuar në të ardhurat totale të lejuara, të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet operacionale të arsyetuara, zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve.

Përcaktimi i të ardhurave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008 ka marrë parasysh si vijon:

- Informatat e dhëna nga NQ Gjakova në aplikacionin e saj për tarifat dhe çmimet për sezonin e ngrohjes 2007/2008;
- Informatat e dhëna nga NQ Gjakova në raportin e vet rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet /investimin, si dhe informatat teknike dhe për konsumatorë që në fakt janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2006/2007;
- Bashkërendimin mes tarifës së tanishme (sezoni i ngrohjes 2006/2007) dhe asaj të planifikuar (sezoni i ngrohjes 2007/2008); Ky bashkërendim është bazuar në ndryshimin midis të ardhurave të planifikuara dhe atyre që aktualisht janë realizuar në sezonin e kaluar të ngrohjes të dhëna në raportimin rregullativ të NQ Gjakovës.

#### Shënime:

- NQ “GJAKOVA” ka dorëzuar në ZRRë aplikacionin për tarifa me 10 shtator 2007;
- ZRRë-ja ka nxjerr komentet për aplikacionin për tarifa të NQ GJAKOVËS me 25 shtator 2007, ku kërkohen korrigjimet, shpjegime dhe informacion / dokumente shtesë;
- Me 28 shtator 2007 NQ “GJAKOVA” ka dorëzuar aplikacionin e përmirësuar që përmbante korrigjimet, shpjegimet dhe informata / dokumentacion shtesë;
- Bashkërendimi i lëshuar nga ZRRë-ja më 29 gusht, 2007.

## **2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore, Norma e Kthimit (RoR)**

Metodologjia e Normës së Kthimit (RoR) është zbatuar me qëllim të llogaritjes së tarifave dhe çmimeve përfshirë këtu përcaktimin e të ardhurave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008.

#### Parimet

Metodologjia më themelore rregullative për aprovimin e tarifave është e ashtuquajtura rregullimi “Norma e Kthimit” (ose rregullimi “kostoja plus”).

Parim bazë është se tarifa për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike duhet të mbulojë shpenzimet, kështu që në njërin anë konsumatorët nuk do të duhej të paguajnë shumë më tepër se sa kostoja e shkaktuar për ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër ndërmarrja e shërbimeve publike duhet të mbulojë të gjitha kostot e arsyetuara plus një normë të arsyeshme të kthimit në

investimet kapitale. Çmimi total i shërbimit zakonisht përcaktohet për të përfshirë të gjitha shpenzimet operuese të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, psh., të mbulojë koston e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit (operimi dhe mirëmbajtja, lënda djegëse, rrogat, shpenzimet e përbashkëta, tatimet, etj.) plus një kthim të arsyeshëm në investime dedikuara ofrimit të shërbimeve publike.

Duke qenë se rregullimi RoR nuk nxit ndërmarrjet për të ngritur efikasitetin operativ dhe të stimulojë kursimin e shpenzimeve, përkundrazi mund të nxisin mbi-investime në mjetet themelore dhe gjithashtu, duke marrë parasysh obligimin e Rregullatorit për të mbrojtur konsumatorët, ajo kërkon që ndërmarrjet jo vetëm të dëshmojnë “shpenzimet e arsyeshme” të deklaruara, por edhe të tregojnë një rritje të efikasitetit operacional dhe efikasitet në blerje. Masat e tilla krijojnë bazë për bashkërendimin e tarifave në fillim të sezonit të tarifave, në të cilën rregullatori shpërblen apo ndëshkon ndërmarrjen për rritjen apo rënien e efikasitetit dhe kontrollit të koston.


### Formulimi

Me qëllim të llogaritjes së të ardhurave të lejuara dhe llogaritjes përfundimtare të tarifave, metodologjia RoR është e përfshirë në Udhëzimin e Përkohshëm I\_05\_2007, ku është dhënë në detaje formulimi i metodologjisë Norma e Kthimit (RoR).

Megjithatë, për arsye konsistence, formulimi do të paraqitet edhe në këtë raport.

Skematikisht, metodologjia RoR mund të tregohet, si më poshtë. Shpenzimet të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga shpenzimet e veta operationale, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësojë asetet e veta, dhe kthimin në bazën e rregulluar të aseteve (RAB), e cila në fakt paraqet fitimin për ndërmarrjen.

**Figura 1: Skema e llogaritjes së të ardhurave të lejuara**



-----  
 (\*)  $\Delta \text{WC}$ : Ndryshimi në kapitalin punues

Formulat bazë të rregullimit:

Të ardhurat e lejuara janë llogaritur sipas formulës:

$$R = OC + \text{Zhvlerësimi Vjetorë} + (RoR \times RAB \text{ Përfundimtarë})$$

Ku:

<b>R -</b>	Të Ardhurat e Lejuara Totale
<b>OC -</b>	Kostot Operacionale Totale
<b>Zhvlerësimi Vjetorë</b>	Zhvlerësimi për vitin përkatës
<b>RoR -</b>	Norma e Kthimit e Lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB)
<b>RAB -</b>	Baza e Rregulluar e Aseteve
<b>(RoR x RAB Përfundimtarë)</b>	Kthimi i Lejuar ose Profiti i Lejuar (vlerë numerike)

Të ardhurat e lejuara paraqesin koston vjetore të kompanisë, e që përmbajnë: i) kostot operacionale, të cilat janë të “arsyetuara”; ii) zhvlerësimin; dhe iii) kthimin e lejuar në Bazën Rregullatore të Aseteve.

Kostot operacionale përbëhen nga pjesa fikse dhe ajo variabile, e formuluar si vijon:

$$OC = OC_F + OC_v$$

Kostot operacionale paraqesin shpenzimet totale të arsyetuara të parashikuara për një vit, e që këtu hyjnë: i) shpenzimet për lëndë djegëse dhe konsumime tjera (energji elektrike, kemikalet e ujit, pjesët rezervë), si dhe humbjet e energjisë; ii) shpenzimet e sistemit operues, riparimi dhe mirëmbajtja; dhe iii) shpenzimet personale dhe të përbashkëta. Kosot operacionale të lejuara nuk përfshijnë: i) subvencionet; ii) shpenzimet e refuzuara nga autoritetet tatimore, dhe shpenzimet e ndarjes së rezervave apo shpërndarjes së tyre; dhe iii) pagesat e qirasë për mjetet që nuk janë të shënuara në llogari mbajtjen, shpenzimet financiare apo shpenzimet tjera të pa arsyetuara.

Baza Rregullatore e Aseteve është llogaritur sipas formulës:

$$RAB = \text{Vlera kontabël e Aseteve (pas Zhvlersimit kumulativ)} + \text{Investimet e reja} + \text{Kapitali Punues}$$

Baza Rregullatore e Aseteve (RAB) paraqet asetet e ndërmarrjes të konsideruara për përdorim dhe të dobishme për shërbime publike, e të cilat përfshijnë: i) vlerën e librave kontabël (pas zhvlerësimit) ose vlerën fillestare të librave kontabël minus zhvlerësimi i akumuluar; ii) investimet e reja kur janë të planifikuara dhe të aprovuara nga rregullatori; dhe iii) kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të realizojë aktivitetet e saj.

Norma e Kthimit është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit, më thjeshtë e quajtur “Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit” (WACC); Vlera e WACC pas tatimit është llogaritur sipas formulës:

$$WACC = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

Ku:

<b>D/V -</b>	Pjesa e borxhit nga baza totale e kapitalit
<b>E/V -</b>	Pjesa e ekuitetit nga baza totale e kapitalit
<b>V -</b>	Baza totale e kapitalit, e cila është I gjithë ekuiteti dhe borxhi
<b>k<sub>d</sub> -</b>	Kostoja e borxhit
<b>k<sub>e</sub> -</b>	Kostoja e Ekuitetit

### 3. Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara

Për përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara të NQ Gjakovës për sezonin 2007-2008, në pajtim me metodologjinë e pranuar RoR, ZRRë ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operacionale të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të Lejuar në RAB (fitimi i lejuar për kompaninë), i cili përfshin:
  - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i aseteve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi, investimet e planifikuara, dhe kapitali punues, dhe
  - b) Llogaritja e Normës së Kthimit të Lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Bashkërendimi i të ardhurave të lejuara aktuale dhe atyre të planifikuara për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008.

Në përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara, ZRRë ka marrë parasysh sa vijon:

- Informatat e ofruara nga NQ Gjakova në aplikacionin e tij për tarifatat dhe çmimet për sezonin e ngrohjes 2007/2008 – informata rreth të ardhurave të parashikuara nga shërbimet që kanë lidhje me ngrohjen, shpenzimet e parashikuara totale, asetet e parashikuara të cilat përfshijnë edhe investimet e planifikuara dhe rrjedhën e parashikuar të parasë, si edhe prodhimin dhe furnizimin e parashikuar të ngrohjes;
- Informatën e ofruar nga NQ Gjakova në raportimin e tij rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet/ investimi, si edhe informatat teknike dhe për konsumatorë të cilat janë realizuar në sezonin 2006/2007;
- Informatat që ZRRë ka nga shqyrtimi i çmimeve dhe përcaktimi i tarifave nga vitet e kaluara.

Duke e ditur se informatat e parashikuara janë kryesore për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, këto do të duhej të ishin të besueshme dhe reale. Përgjithësisht, në parashikimin / planifikimin e biznesit do të duhej të kemi qasje reale të përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve të shumtë që ndikojnë në biznesin; p.sh., vlerësimi i tregut dhe parashikimi i zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vlerësimi i prodhimit / mundësitë e furnizimit dhe mundësitë financiare të kompanisë. Natyrisht, parashikimi/planifikimi i drejtë duhet të bazohet në të dhënat që kompania I ka realizuar në të kaluarën gjatë periudhës së caktuar.

Duhet cekur këtu se, se përkundër faktit që aplikacioni për tarifa i NQ Gjakova ka qenë mjaft detal, dhe më i saktë dhe më komplet se vitet e kaluara, në disa pika janë vërejtur disa mospërputhje, dhe informata jo-komplete dhe jo të sakta. Përkundër ndërhyrjes së ZRRë-së me komente në formë të kërkesës për përmirësim apo kompletim, megjithatë për disa pozicione nuk kemi marrë shpjegime të kënaqshme apo korrigjime të duhura, dhe se disa informata të përmendura më lartë shpesh kanë qenë jo-komplete, jo-reale dhe të pa mbështetura me dokumentacion përkatës – jo në pajtim të plotë me udhëzimin e raportimit rregullativ, dhe me udhëzimin për tarifatat dhe çmimet (Udhëzimet I\_04\_2007 dhe I\_05\_2007) – që ka shkaktuar vështirësi shtesë.

Në fakt, sa i përket informatave të parashikuara (përcaktuar në nenin 7.2 pika “d”), NQ Gjakova i ka dorëzuar ZRRë-së, tabelën që përshijnë të hyrat e parashikuara dhe shpenzimet, mbështetur me të dhëna të pakta teknike dhe të konsumatorëve; bilansi i parashikuar i gjendjes, rrjedhën e parashikuar të parasë për periudhën që mbulon plotësisht sezonin e ngrohjes qendrore – 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, dhe draftin e raportit të auditorëve për pasqyrat financiare. Edhe pas komenteve të ZRRë-së në formë të kërkesës për përmirësim, kompletim dhe shpjegim shtesë,

përsëri disa të dhëna ishin jo të sakta dhe jo-komplete, si dhe NQ Gjakova nuk ka dorëzuar raportin final të auditorëve.

Pavarësisht nga kjo, ZRrE-ja ka bërë përpjekje për të bërë vlerësimin e informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e NQ Gjakovës. Është bërë një analizë e thellë dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave nga sezoni i kaluar, me qëllim që të bëhet përcaktimi i saktë i të ardhurave të lejuara për sezonin që vjen 2007/2008.

### 3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operacionale të lejuara

Kostot operacionale të dorëzuara nga ana e NQ Gjakovës për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, periudhë kjo që mbulon gjithë sezonin e ngrohjes qendrore 2007/2008, janë strukturuar në kosto variabël dhe fikse. Megjithatë kjo ndarje në kuptimin e alokimit të komponentëve përkatëse në grupet respektive të kostove nuk mund të thuhet se është në pajtim të plotë me parimet e avancuara të kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Në këtë seksion do të tregohen në mënyrë tabelare shpenzimet e parashikuara siç janë prezantuar nga NQ Gjakova dhe shpenzimet operacionale të lejuara që ZRrE i ka aprovuar (Tabela1.) Në vijim të tabelës jepet shpjegimi analitik për secilin pozicion të kostove operacionale.

**Tabela 1 – Kostot e paraqitura nga ana e NQ Gjakova SH.A., dhe ato të lejuara nga ana e ZRrE-së për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, e që përfshin gjithë sezonin e ngrohjes 2007/2008**

Në €

<b>Costs / Kostot</b>		<b>DH/NQ GJAKOVA JSC</b>		Proposed by	Allowed by
				Propozuar nga DH Gjakova	Lejuar nga ZRrE
	<b>Variable costs:</b>	<b>Kostot</b>	<b>variabël</b>		
1	Heavy oil	Mazut		580,000	548,850
2	Transport	Transporti		500	500
3	Diesel	Naftë		2,000	2,000
4	Fuel (petrol)	Benzinë		6,000	4,000
5	Chemicals	Kemikaljet		3,000	3,000
6	Water	Uji		6,000	4,500
7	Electricity	Energia elektrike		60,000	50,000
8	Staff cost (dir. labor)	Kosto e personelit (puna direkte)		68,770	68,770
9	<b>total variable</b>			<b>726,270</b>	<b>681,620</b>
	<b>Fixed costs</b>	<b>Kostot</b>	<b>fikse:</b>		
	<b>Materials, Services</b>	<b>Materialet/Shërbimet</b>			
10	Spare parts	Shpenz. e pjeseve rez.		8,000	8,000
11	Repairs	Riparimi		16,000	15,000
12	Maintenance	Mirmbajt.		8,000	6,000
13	Small items	Shp. Materiali imte		2,000	2,000
14	Cleaning	Shp. Direkte pastrim		700	500
15	Office Supply	materiali zyrtar		2,500	2,500
16	Fuels	derivate		700	500
17	<b>Sub-total</b>			<b>37,900</b>	<b>34,500</b>
	<b>Personnel Costs</b>	<b>Shpenzimet e Personelit</b>			


18	Salaries	Pagat mujore		72,000	72,000
19	Food	Ushqimi		11,500	11,500
20	Sal. of Board. Memb.	Pagat e Anëtar. Bordit		4,840	4,840
21	Pension fund	Fondi per Pension		4,410	4,410
22	<b>Sub-total</b>			<b>92,750</b>	<b>92,750</b>
	<b>Other oper. costs</b>	<b>Shpenzimet tjera operative</b>			
23	Auditing	Auditimi		15,000	12,000
24	Telephone	Telefoni		3,500	2,500
25	Representation	Reprecentacioni		3,000	3,000
26	Advertising	Reklama, publikime		5,000	3,000
27	Financial costs	Shp. Fin.		2,000	2,000
28	Municipality costs	Shp. Kommunale		6,000	3,500
29	Other administration	Shp. tjera admin.		2,500	1,500
30	Computer materials	Materiale kompj.		2,500	2,500
31	Licensing fee	Pagesa per license		1,500	1,800
32	Admin / Court fee	Taksa admin / gjyqësore		8,000	4,000
33	Others	Tjera		7,000	2,000
34	<b>Sub-total</b>			<b>56,000</b>	<b>37,800</b>
35	<b>Total Fixed Costs</b>	<b>Totali i Shpenzimeve Fikse</b>		<b>186,650</b>	<b>165,050</b>
36	<b>Total Operational Costs</b>	<b>Totali i Shpenz. Operative</b>		<b>912,920</b>	<b>846,670</b>
37	<b>Fixed costs</b>	<b>Kostot fikse</b>		186,650	165,050
38	<b>Variable costs</b>	<b>Kostot variab.</b>		726,270	681,620
39	<b>Subsidy for mazut</b>	<b>Subvenc. per mazut</b>		200,000	200,000
40	<b>Subsidy for repairs</b>	<b>Subvenc. per riparime</b>		150,000	150,000
41	<b>Allowed operational costs (OC)</b>	<b>Kostot e lej. oper.</b>		<b>562,920</b>	<b>496,670</b>
42	<b>Fixed part of OC</b>	<b>(OCf) Pjesa Fikse</b>		<b>115,091</b>	<b>96,821</b>
43	<b>Variable part of OC</b>	<b>(OCv) Pjesa Variab.</b>		<b>447,829</b>	<b>399,849</b>

#### Të dhënat teknike dhe për konsumatorë (të dhëna mbështetëse në lidhje me kostot)

Heating space	m2	Sip. ngroh.	Residential	Amvisri	69,000	69,000
Heating space	m2	Sip. ngroh.	Com.&inst.	Kom Inst.	75,000	75,000
Tot. heat. Sp.	m2	Sip. Ng. tot.			144,000	144,000
Staff	-	Personeli			34	34
Average salary	Euro	Paga mes.			311	311
Cost of salaries	Euro	Kost. pagave			126,888	126,888
Product. of heat	MWh	Prodh. ngr.			21,357	18,225
Sales of heat	MWh	Shitja e ngr.			18,153	15,491
Cons. of mazut	ton	Kons. i maz.			2,000	1,920
Price of mazut	Euro/t	Cmimi i maz.			290	290
Av. cost per ton	Euro/t	Kost.mes/ ton			S'është paraq.	285.86
Cost of mazut	Euro	Kost. e maz.			580,000	548,850

Në diagramin e mëposhtëm janë paraqitur në mënyrë skematike kostot kryesore siq janë propozuar nga NQ Gjakova dhe pranuar nga ZRrE-ja:

**Figura 2. Paraqitja skematike e kostove kryesore të propozuara nga NQ Gjakova dhe të pranuar nga ZRrE-ja për sezonin e ngrohjes 2007/2008**



### Shpjegim analitik

Shpjegimi analitik i dhënë më poshtë për secilin grup të kostove dhe për pozicionet kryesore përbërës të grupeve të veçantë të kostove, jep një shpjegim të detajizuar dhe arsyetimin për përcaktimin e kostove të lejuara.

#### - Kostot variabël:

- Pozicioni Nr.1 – mazuti:
  - Kostoja e mazutit e propozuar nga NQ Gjakova (€580,000) është bazuar në sasinë e parashikuar të konsumit 2,000 ton dhe çmimin e blerjes prej 290 €/ton; çmimi i propozuar i blerjes është vlerësuar duke marrë parasyh çmimet e blerjes në sezonin e kaluar që përbëhet nga çmimi i “Platts-it” (I tregut), taksa doganore dhe premiumi, si dhe çmimet e naftës në tregje. Duhet cekur se çmimi I tregut (Platts) ka shënuar rritje konstante që ka ndikuar në ngritjen e çmimit total të blerjes së mazutit.
  - Bazuar në kërkesën e konsumatorëve për ngrohje, aftësinë e NQ Gjakovës që të plotësoj këtë kërkesë (në disa studime për sektorin e ngrohjes në Kosovë është vlerësuar 75 – 80 % – për këtë sezon ZRrE-ja ka adaptuar 75%), duke llogaritur humbjet e gjenerimit dhe distribuimit, dhe bazuar në të dhënat për konsumin e lëndës djegëse, gjenerimin dhe furnizimin e ngrohjes për sezonët e mëparshëm, posaqërisht për sezonin 2006/07, ZRrE vlerëson se sasia prej 1,920 ton mazut është e mjaftueshme.
  - Kostoja e mazutit e lejuar nga ZRrE-ja prej € 548,850 është llogaritur në bazë të sasisë së pranuar 1,920 ton dhe koston mesatare njësi të mazutit 285.86 €/t. Llogaritja e koston së mazutit është bërë duke marrë parasysh si vijon:
    - Rezerva e mazutit në fund të sezonit 2006/07 ka qenë 473.27 tona
    - Kostoja mesatare njësi e mazutit për sezonin 2006/07 ka qenë 273.20 €/t
    - Për sa u tha më lartë për të arritur sasinë e parashikuar të konsumit të mazutit prej 1,920 ton, NQ Gjakova në sezonin 2007/08 duhet të blejë sasinë prej:
 
$$1,920 - 473.27 = 1,446.73 \text{ tona.}$$
    - Kostoja e mazutit rezervë është:  $473.27 \text{ t} * 273.20 \text{ €/t} = \mathbf{129,298 \text{ €}}$
    - Kostoja e mazutit që duhet blerë në sezonin 2007/08 është:
 
$$1,446.73 \text{ t} * 290 \text{ €/t} = \mathbf{€ 419,552}$$

- Kostoja e përgjithshme e mazutit për sezonin 2007/08 do të jetë:  
129,298 € + 419,552 € = € **548,850**
- Shënim: Për mbulimin e koston së mazutit, është parashikuar që Buxheti I Kosoliduar I Kosovës të japë subvencion për blerjen e mazutit në vlerë prej € 200,000. Vlera e subvencionuar nuk pranohet si kosto reale e kompanisë.
- Pozicioni Nr. 2 – Transporti and Pozicioni Nr. 3 – Dizeli janë pranuar ashtu siq janë propozuar nga NQ Gjakova.
- Pozicioni Nr. 4 – Benzina
  - Në aplikacionin për tarifa NQ Gjakova ka propozuar koston e benzinës në vlerë prej € 6,000;
  - ZRrE-ja vlerëson se ky është një parashikim shumë i lartë i konsumit të benzinës, pasi që në sezonin 2006/2007, kostoja aktuale e benzines dhe dizelit së bashku ka qenë € 3,486. Për këtë ZRrE-ja vendos të pranoj koston e benzines në vlerë prej €4,000
- Pozicioni Nr 5 – Kemikaljet dhe Pozicioni Nr 6 – Uji:
  - Kostoja e kemikaljeve për trajtimin e ujit dhe kostoja e ujit të konsumuar e propozuar nga NQ Gjakova është € 3,000 respektivisht € 6,000; për vlerat e propozuara nuk është dhënë ndonjë shpjegim shtesë, për të arsyetuar kostot e paraqitur, p.sh. sasi të dhe çmimet korresponduese.
  - Në raportimin regullativ NQ Gjakova ka paraqitur koston e ujit të trajtuar (që paraqet ujin e pa-trajtuar dhe kemikaljet) në vlerë prej € 4,255. Duke marrë parasysh këtë, dhe gjithashtu duke marrë parasysh konsumin e ujit të parashikuar prej 7,350 m<sup>3</sup> për sezonin e ardhshëm të paraqitur nga NQ Gjakova, dhe çmimin aktual të ujit prej 0.55€/ m<sup>3</sup>, ZRrE-ja ka vlerësuar se **kostoja e propozuar për kemikalje prej € 3,000** është e pranueshme, përderisa për **ujin e patrajtuar** ka vendosur që të pranoj koston prej **€4,500**. NQ Gjakova duhet të përpiqet që të parandaloj dhe riparoj rrjedhjet e ujit në sistemin e distribuimit, për të minimizuar humbjet e ujit dhe të ngrohjes.
- Pozicioni Nr. 7 – Kostoja e energjisë elektrike:
  - NQ Gjakova ka propozuar koston e energjisë elektrike në vlerë prej € 60,000, që paraqet një rritje nga vitet e kaluara, e cila rritje arsyetohet me zgjerimin e rrjetit për 3 km. Më sakt, për sezonin 2006/2007 ishte parashikuar dhe lejuar kostoja e energjisë elektrike € 55,000, përderisa kostoja aktuale e energjisë elektrike për sezonin 2006/2007 ishte € 47,460.
  - Duke marrë parasysh faktet e përmendura më lartë, e gjithashtu duke ditur se çmimi e energjisë elektrike ka mbetur i njëjtë, dhe se zgjerimi i rrjetit nuk është aq sa të ndikoj dukshëm në rritjen e ksotos së energjisë elektrike, ZRrE-ja vendos të lejoj **koston e energjisë elektrike** në vlerë prej **€ 50,000**.
- Pozicioni Nr. 8 – Kostoja e personelit (puna direkte) propozuar nga NQ Gjakova në shumë totale € 68,770 dhe përbëhet nga:
  - Pagat: € 55,000
  - Ushqimi: € 10,500, dhe
  - Kontributi Pensional: € 3,270,

ZRrE-ja ka pranuar **koston e personelit (puna direkte)** të propozuar në vlerë totale prej **€ 68,770**.

Kostot totale variabile të pranuar nga ZRrE-ja si të arsyeshme janë **€ 681,620**, që është për €44,650 më pak se kostot totale variabile të propozuara nga NQ Gjakova (€ 726,270); megjithatë

kostot variabile të pranuar nga ZRrE-ja janë për € 106,284 më të larta se kostot aktuale variabile sipas vendimit të ZRrE-së për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€ 575,336). Kjo rritje e kostove variabile në krahasim me sezonin e kaluar është për shkak të konsumit dhe kostos më të madhe të mazutit, që ZRrE-ja ka vendosur të lejoj, për shkaqet e përshkruara nën pozicionin Nr. 1 më lartë, në mënyrë që të mbuloj kostot shtesë për zgjerimin e planifikuar të rrjetit dhe rritjen e bazës së konsumatorëve.

- Kostot fikse

- Grupi i kostove – Materialet dhe Shërbimet:

- Pozicioni Nr.10 – **Kostja e pjesëve rezervë** është pranuar siq është paraqitur nga NQ Gjakova në vlerë prej € **8,000**.
- Pozicioni Nr. 11 – Riparimet dhe Pozicioni Nr. 12 – Mirëmbajtja:
  - Kostoja për riparime dhe mirëmbajtje e propozuar nga NQ Gjakova është €16,000 respektivisht €8,000; përderisa në raportimin rregulativ të kostove aktuale për sezonin 2006/2007, kostoja e përbashkët e mirëmbajtjes dhe riparimeve e raportuar nga NQ Gjakova ishte €12,556.
  - Duke konsideruar këtë divergjencë të madhe në mes të kostos së propozuar për riparime dhe mirëmbajtje për sezonin 2007/2008 ndaj atyre të raportuara si aktuale për sezonin 2006/2007, ZRrE-ja nuk ka mund të pranoj vlerën e propozuar; megjithatë, në mënyrë që NQ Gjakova të mund të përmirësoj kualitetin e ngrohjes dhe shërbimin ndaj konsumatorëve, ZRrE-ja ka lejuar që **kostoja për riparime** të jetë **€15,000** dhe **kostoja për mirëmbajtje** të jetë **€6,000**. Kjo shumë është pak më e vogël se që është propozuar, por përsëri mjaft më e lartë se kostoja aktuale për riparime dhe mirëmbajtje e raportuar për sezonin e kaluar.
- Pozicioni Nr. 13: Kostoja e inventarit të imët dhe Pozicioni Nr. 15: Mateiali për zyre – janë pranuar siq janë propozuar nga NQ Gjakova në vlerë prej € **2,000** respektivisht **€2,500**.
- Pozicioni Nr. 14: “Kostoja për pastrim” dhe pozicioni Nr. 16: “Kostoja për karburante” janë reduktuar nga €700 në €500 siq ishte lejuar për sezonin e kaluar.

- Grupi i kostove – Kostoja e Personelit (e ndryshme prej ”punës direkte”)

- Pozicioni Nr. 18 – Pagat
  - Kostoja për paga e propozuar nga NQ Gjakova është € 72,000  
Shënim: Pagat totale të kompanisë (puna direkte dhe departamentet tjera) janë €127,000, që përputhet me llogaritjen për numrin e personelit 34 dhe pagën mesatare mujore prej € 311.
  - Pasi që kostoja e pagave përafërsisht përputhet me koston e pagave aktuale të raportuar për sezonin 2006/07, dhe gjithashtu përafërsisht përputhet me tabelën e pozitave dhe pagave respektive që është siguruar nga ZRrE-ja, është vendosur që të pranohet kostoja propozuar për paga.
- Pozicioni Nr. 19 – Kostoja e ushqimit
  - Kostoja për ushqim e propozuar nga NQ Gjakova është €11,500;
  - Shënim: Kostoja e ushqimit për tërë personelin e kompanisë është (puna direkte dhe departamentet tjerë) është €22,000, 000 që është llogaritur për 34 punëtorë që marrin nga €54/muaj.

- Edhe pse është vërejtur një rritje e vogël nga viti i kaluar (nga 52 €/muaj në 54 €/muaj), ZRrE-ja ka vendosur të pranoj koston e ushqimit siq është paraqitur nga NQ Gjakova.
- Pozicioni Nr. 20 – pagat e anëtarëve të Bordit: NQ Gjakova ka paraqitur **pagesat e anëtarëve të bordit** në vlerë prej **€ 4,840**, dhe ZRrE-ja i ka pranuar.
- Pozicioni Nr. 21 – Fondi pensional (kontributi i paguar nga kompania)
  - Kostoja për kontributin pensional e paraqitur nga NQ Gjakova është €4,410;
  - Sipas rregullores për kontributin pensional, 5% e të ardhurave të punëtorëve paguhet nga kompania; pra ZRrE-ja pranon **koston për kontributin pensional** të paraqitur nga NQ Gjakova në vlerë prej **€4,410**.
- Grupi i Kostove – Kostot tjera fikse
  - Pozicioni Nr.23 – Kostoja e auditimit
    - NQ Gjakova ka propozuar koston e auditimit në vlerë prej € 15,000 dhe për këtë shumë nuk ka paraqitur ndonjë evidencë shtesë p.sh. faturat nga auditimet e viteve të kaluara.
    - Në vijim të çasjes se kostoja e auditimit varet dhe përcaktohet nga ofertat e tenderimit, ZRrE-ja ka vendosur të lejoj **€ 12,000** për **koston e auditimit**
  - Pozicioni Nr. 24 – Kostoja e komunikimeve telefonike
    - Kostoja për telefonata e paraqitur nga NQ Gjakova është € 3,500.
    - ZRrE-ja ka lejuar **koston për telefonata** në vlerë prej **€2,500**, duke rekomanduar se kostot administrative duhet minimizuar sa më shumë të jetë e mundur.
  - Pozicioni Nr. 25 – Representacioni
    - Kostoja për representacion e propozuar nga NQ Gjakova është €3,000;
    - ZRrE-ja ka vlerësuar se kjo kosto duhet mbajtur në nivel të arsyeshëm, dhe ka lejuar vlerën prej **€ 3,000** për **koston e reprezentacionit**.
  - Pozicioni Nr. 26 – Reklamat dhe publikimet e njoftimeve
    - NQ Gjakova ka propozuar që kostoja për reklama të jetë € 5,000;
    - ZRRE-ja e ka parasysh nevojën për reklamim; megjithatë, pasi që ngrohja qendrore është e limituar për territorin e komunës, atëher vetëm reklamimi në mediat lokale duhet të bëhet. Pra ZRrE-ja vlerëson dhe lejon **koston për reklamim** në vlerë prej **€3,000**.
  - Pozicioni Nr.27 – Kostoja financiare
    - Kostoja financiare e paraqitur nga NQ Gjakova është € 2,000.
    - ZRrE-ja vlerëson kjo shumë korrespondon me transaksionet financiare të zakonshme që bëhen nga kompanija, dhe pranon **koston financiare** në vlerë prej **€ 2,000**.
  - Pozicioni Nr.28 – Kostot Komunale
    - Shpenzimet komunale të propozuar nga NQ Gjakova janë € 6,000, për të cilën është dhënë shpjegimi shtesë me shkrim se në këtë kosto përfshihet tatimi në pronë dhe kosotja e largimit të mbeturinave dhe ujrave të zeza. Në raportimin rregullativ të sezonit të kaluar ishin raportuar kostot komunale në vlerë prej € 2,636, e që përbëhet nga tatimi në pronë në vlerë prej € 1,647 dhe largimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza në vlerë prej € 989.

- ZRRE-ja vlerëson se kjo shumë e parashikuar është e madhe dhe duke marrë parasysh faktet e dhëna më lartë ka vendosur të pranoj dhe lejoj **kostot komunale** në vlerë prej **€ 3,500**.
- Pozicioni Nr. 29 – Kostot tjera administrative
  - Kostot tjera administrative prej €2,500 janë propozuar nga NQ Gjakova, pa e japur ndonjë detalizim apo shpjegim;
  - Duke pasur parasysh qasjen se kostot administrative duhet të jenë sa më të ulta, ZRRE-ja vlerëson se për **kostot tjera administrative** vlera prej **€ 1,500** është e arsyeshme.
- Pozicioni Nr. 30 – Materialet kompjuterike
  - NQ Gjakova ka paraqitur këtë kosto në vlerë prej €2,500;
  - ZRRE-ja vlerëson se **kostoja e materialeve kompjuterike** në shumën prej **€2,500** duhet të lejohet si e justifikueshme.
- Pozicioni Nr.31 – Pagesa për licensë
  - NQ Gjakova ka paraqitur këtë kosto në vlerë prej €1,500, e cila kosto nuk korrespondon me gjenerimin e ngrohjes të parashikuar të paraqitur nga ta.
  - Bazuar në llogaritjen tonë të gjenerimit të ngrohjes (ca. 18,000 MWh) dhe pasyrën e pagesave për licensë të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, është pranuar **kostoja e pagesës për licensë** në vlerë prej **€1,800**
- Pozicioni Nr. 32 – Taksat Gjyqësore/Administrative:
  - NQ Gjakova ka paraqitur këtë kosto në vlerë prej € 8,000, e cila është bazuar në shpenzimet e parashikuara që shkaktohen për të ngritur padinat pranë gjykatave kundër borxhlinjëve.
  - Edhe pse ZRRE-ja e njeh këtë shpenzim, bazuar në numrin mesatar të padive si dhe taksës gjyqësore prej €35 – €150 mvarsisht nga “vlera e kontestit”, ZRRE-ja vlerëson se **€ 4,000** për këto kosto janë të arsyeshme dhe të lejueshme.
- Item No. 33 – Tjerat
  - Kostoja nën pozicionin “tjera” është propozuar të jetë € 7,000, duke deklaruar se kjo kosto kryesisht përbahe prej paisjeve të sigurisë (p.sh. aparatet zjarrëfikse etj.), por pa specifikuar saktësisht se cilat kosto janë përfshirë si dhe vlerat përkatëse;
  - ZRRE-ja konsideron se kjo kosto është e tepërt dhe lejon vetëm **€ 2,000** për koston nën pozicionin “tjerat”.

Shpenzimet totale fikse të pranuar si të arsyeshme nga ZRRE-ja janë në lartësin prej **€165,050**, që është €21,600 më pak se totali i kostove fikse të propozuara nga NQ Gjakova €186,650; megjithë kostot fikse të pranuar janë dukshëm më të larta (€28,800) se kostot fikse të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€136,250). Kjo vlerë e lejuar mendohet se do të mbuloj të gjitha kostot e arsyeshme fikse të kompanisë duke supozuar se NQ Gjakova do ta përmirësoj shërbimin ndaj konsumatorëve duke mirëmbajtur sistemin në mënyrë të rregullt, të parandaloj prishjet në sistemin e ngrohjes, dhe me kohë të reagoj në evitimin dhe riparimin e prishjeve eventuale. Shpenzimet fikse të lejuara gjithashtu është menduar të mbulojnë shpenzimet që kanë të bëjnë me përpjekjet e shtuara në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të kompanisë, përmirësimin e sistemit të kontabilitetit, krijimin e sistemit të informimit dhe raportimit të menaxhmentit, dhe si më ë rëndësishmja rritjen e arkëtimit të pagesave e po ashtu edhe zbulimin dhe parandalimin e kyçjeve ilegale/furnizimit ilegal me ngrohje.

### - Kostot Operacionale të Lejuara

Shpenzimet operacionale të lejuara janë të barabarta me shumën e shpenzimeve fikse dhe atyre variabël dhe nuk përfshijnë vlerën e subvencionit.

NQ Gjakova ka paraqitur subvencionin për lëndë djegëse (mazut) në vlerë prej €200,000; kjo vlerë paraqet një sasi të caktuar të shpenzimeve totale të mazutit, që planifikohet të dhurohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. NQ Gjakova ka paraqitur edhe një subvencion shtesë në vlerë prej €150,000, i cili parashikohet të merret për punimet e riparimeve. Kjo jep totalin e subvencioneve në vlerë prej **€350,000**.

Kjo vlerë e subvencionit është pranuar nga ZRrE-ja siq është paraqitur nga NQ Gjakova.

Vlera e subvencionuar nuk është pranuar si shpenzim real i kompanisë dhe si e tillë nuk mund të përfshihet në kostot e lejuara operacionale.

Shpenzimet operacionale të lejuara janë llogaritur sipas formulës së shënuar më poshtë:

$$\text{OC} = \text{Kostot Variabile} + \text{Kostot Fikse} - \text{Subvencionet}$$

Nga formula llogaritet:

**Shpenzimet operacionale të lejuara janë në vlerë prej €496,670.**


Kjo vlerë paraqet kostot operacionale totale të lejuara nga ZRrE-ja, që janë për €66,250 më pak se kostot operacionale të propozuara nga NQ Gjakova (€562,920). Megjithatë, këto kosto janë më të larta për €105,233 se kostot e parashikuara/lejuara për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€391,437), si dhe këto kosto janë më të larta për €127,853 se sa kostot aktuale operacionale sipas vedimit të ZRrE-së për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€368,817). Kjo rritje e kostove operacionale të lejuara në krahasim me sezonin e kaluar është kryesisht për shkak të zgjerimit të planifikuar të rrjetit dhe rritjes së bazës së konsumatorëve, që shkakton rritjen e komponenteve të kostove në përgjithësi.

Bazuar në proporcionin e kostove fikse ndaj atyre variabile, ndarja në pjesën fikse dhe variabile të kostove operacionale të lejuara është si vijon:

**Pjesa fikse e kostove operacionale të lejuara (OCf) është €96,821, është**  
**Pjesa variabël e kostove operacionale të lejuara (OCv) është €399,849.**

Në diagramin e mëposhtëm janë paraqitur kostot operacionale të lejuara pa përfshirë subvencionet siq janë propozuar nga NQ Gjakova dhe pranuar nga ZRrE-ja:

**Figura 3: Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Gjakova dhe të lejuara nga ZRrE-ja për sezonin e ngrohjes 2007/2008**



### 3.2 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit

NQ “Gjakova” ka paraqitur vlerën e zhvlerësimit vjetor prej €280,000 për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008. Pasi që nuk është paraqitur llogaritja detale e zhvlerësimit, ZRrE-ja ka përcaktuar zhvlerësimin vjetor bazuar në vlerësimet e mëposhtme. Në ndërkohë ne e inkurajojmë NQ “GJAKOVA” të na paraqet sa më shpejt të jetë e mundur llogaritjen detale të zhvlerësimit vjetor dhe kumulativ.

Bazuar në eksperiencën e kaluar, zhvlerësimi është llogaritur në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/3 e cila parasheh tri kategori të zhvlerësimit:

- Ndërtesat dhe struktura e përherëshme – (5%)
- Pajisjet, automjetet dhe kamionët e lehtë, kompjuterët, pajisjet tjera ndihmëse dhe pajisjet për procedimin e të dhënave, inventari i zyrës dhe pajisjet, instrumentet, gjëra të ndryshme dhe pajisje shtesë – (20%).
- Objekti dhe makineria, mjetet e rënda të transportit, pajisjet për kryerjen e punëve të dheut, mjetet tjera të rënda, dhe të gjitha asetet tjera të prekshme – (15%).

ZRrE-ja ka vlerësuar zhvlerësimin vjetor për sezonin e ngrohjes 2006-2007 dhe në bashkërendimin final është definuar në €181,800. Ne supozojmë se për sezonin e ngrohjes 2007-2008 nuk do të ketë ndonjë tjetërsim të aseteve të investuara; dhe jo ndonjë investim tjetër nga ai që është në RAB-in përfundimtarë, në fund të sezonit 2006-2007 ishte zhvlerësuar tërësisht. Me këtë ne mund ta marrim të njëjtin zhvlerësim për investimet ekzistuese për sezonin e ngrohjes 2007-2008 si ai për sezonin 2006-2007, e që është €181,800. Ne i shtojmë 15% zhvlerësim në investimet e reja prej €8,320 nga sezoni I ngrohjes 2006-2007, që është i barabartë me €1,248; dhe do të shtojmë dhe zhvlerësimin në investimet e reja të planifikuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008, në vlerë prej €200,000 minus €150,000 financim nga donacionet, që është i barabartë me €50,000. Ne parashikojmë që këto investime të reja kryesisht janë në makineri dhe pajisje, që ka një zhvlerësim vjetor 15% ose shumën ekuivalente prej €50,000 \* 15% = €7,500. Në total ne fitojmë **zhvlerësimin vjetor** për sezonin e ngrohjes 2007-2008 prej:

$$€181,800 + €1,248 + €7,500 = €190,548$$

### 3.3 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)

Siç u përmend më parë, llogaritja/përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB përfshin:

- formimin (vendosjen) e Bazës Rregulluar të Aseteve (RAB); dhe
- llogaritjen e Normës së Kthimit të lejuar (RoR), të përcaktuar në vlerën e WACC.

Këto dy element të rëndësishme do të llogariten detalisht si më poshtë.

#### 3.3.1 Vendosja e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Vendosja e RAB-it përfundimtar është faktori kryesor për llogaritjen e profitit të lejuar të kompanisë. RAB-i përfundimtarë përbahet nga vlera kontabël e asetve fikse, investimet e reja të planifikuara dhe kapitali punues.

##### 3.3.1.1 Përcaktimi i Vlerës së Aseteve Ekzistuese Fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)

NQ “GJAKOVA” i ka paraqitur ZRRE-së vlerën e parshikuar të asetve fikse në formë të Bilasit të Gjendjes të parashikuar për periudhën 2007 – 2008, që kap shumën €2,963,000, e cila vlerë reflekton vlerën e asetve siq deklarohet në bilansin e gjendjes në 31 dhjetor 2006 të raportit të auditorëve. Lidhur me vlerën kontabël të asetve fikse në bilansin e gjendjes në 31 dhjetor, në raportin e auditorëve qartë përmendet se nuk ka ndonjë provë se si është kryer testi i korigjimit (“impairment”) për pozicionet kryesore të pronës, makinerisë dhe paisjes dhe për pasoj **auditorët nuk kanë qenë në gjendje të jenë të sigurt** në neto vlerën e bartur kontabël të pronës, makinerisë dhe paisjes të NQ “Gjakovës” me 31 dhjetor 2006. Për këtë asye ZRRE-ja ka vendosur të marrë vlerën e asetve fikse pas zhvlerësimit të akumuluar si në bashkërendimin e lejuar nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2006-2007, që ishte €1,969,219. ZRRE-ja do të shtoj investimet e reja siq janë përmendur në bashkërendimin për sezonin 2006-2007, që është €8,320, pra totali i asetve fikse neto në fund të 2006-2007 definohet në €1,977,539. Nga kjo shumë ZRRE-ja do të zbres zhvlerësimin vjetor për sezonin e ngrohjes 2006 -2007, që është €181,800; dhe 15% i €8,320 investime të reja, që është e barabart me €1,248; ose në total €183,048. Rrjedhimisht, **vlera finale kontabël e asetve fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)**, është definuar në vlerën €1,977,539 - €183,048 = **€1,794,491** për sezonin e ngrohjes 2007-2008.

##### 3.3.1.2 Përcaktimi i Investimeve të Reja

NQ “GJAKOVA” ka paraqitur në Pasyrën e Rrjedhjes së Parasë Gatshme dhe Bilansin e Gjendjes për periudhën 15 tetor 2007 gjerë 14 tetor 2008, investimet e reja të planifikuara prej €200,000. Për investimet e propozuara nuk është paraqitur asnjë nga detajet e kërkuara siq është specifikimi i projekteve investive, fizibilitetin financiar dhe teknik etj. Megjithatë NQ “GJAKOVA” ka përmendur se do të marrë €150,000 donacion për ti realizuar këto investime. Për pasoj ZRRE-ja e merr për bazë vetëm shumën e investuar nga burimet e vet kompanisë €200,000 minus €150,000, që është e barabartë me **€50,000 si investime të reja** në Bazën e Rregulluar të Aseteve.

### 3.3.1.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues

NQ "GJAKOVA" nuk ka paraqitur Kapitalin Punues të llogaritur, por ka paraqitur bilansin e gjendjes të parashikuar për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008; ZRrE-ja ka analizuar Asetet Korrente dhe Detyrimet Korrente siq janë deklaruar aty dhe ka llogaritur kapitalin punues si më poshtë:

#### **Bilansi i Gjendjes i Parashikuar**

Në €

##### Asetet Korrente

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	73,000
Logaritë e Arkëtueshme	278,100
Stoqet	88,000
Asetet tjera korrente	60,000

-----  
**Total Asete Korrente** **499,100**  
-----

Në €

##### Detyrimet Korrente

Llogaritë e pagueshme	46,100
Detyrimet e shtyera	132,000
Detyrimet tjera korrente	51,000

-----  
**Total Detyrimet Korrente** **229,100**  
-----

-----  
**Kapitali Punues** **270,000**  
-----

Siq u tha më lartë kapitali punues nuk ishte llogaritur dhe raportuar në aplikacionin për tarifa të NQ GJAKOVA dhe bazuar në bilansin e parashikuar të gjendjes **Kapitali Punues** është i barabart me **€270,000**. Kjo shumë do të merret parasysh nga ZRrE-ja si objektiv për kapitalin punues për sezonin 2007-2008, me qëllim të llogaritjes së Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB).

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) llogaritet si vijon:

$$\text{RAB} = \text{Vlera Kont. e Aseteve (pas zhvler.)} + \text{Invest. e Reja} + \text{Kapitali Punues}$$

**Dhe që rezulton siq është në tabelën 2, në vlerë prej € 2,114,491.**

Në Tabelën 2 më poshtë ne përmbledhim komponentet e RAB-it përfundimtarë dhe vlerën respektive.

**Tabela 2: RAB-i përfundimtarë i NQ GJAKOVA dhe komponentet e tij për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008**

		In €	
Baza e Rregulluar e Aseteve - NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008		Proposed by Propozuar nga DHC GJAKOVA	Allowed by ERO Lejuar nga ZRrE
3.3.1.1.	Vlera kontabël e asetëve fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)	2,963,000	1,794,491
3.3.1.2.	Investimet e Reja (donacionet nuk përfshihen)	200,000	50,000
3.3.1.3.	Kapitali Punues	270,000	270,00
	<b>Baza e Rregulluar e Aseteve</b>	<b>3,433,000</b>	<b>2,114,491</b>

### 3.3.2 Llogaritja e Normës së Kthimit të Lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve për të gjitha Kompanitë e Ngrhjes Qendrore në Kosovë

Objektivi i Normës së Kthimit të arsyeshme (RoR) në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), është të garantoj ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për një fitim që lejon të vazhdohet me investimet në asete, në mënyrë që të mund ti zëvendësoj dhe zgjeroj ato.

Një RoR i arsyeshëm konsiderohet të jetë norma e “Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit” (WACC), që llogaritet në bazë komponenteve të bazës së kapitalit, duke marrë parasysh ponderimet e shumave të këtyre komponenteve të kapitalit. Me fjalë tjera, WACC-u është shuma e mesatarës së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit.

Për koston e ekuitetit, ZRrE-ja ndjek metodologjinë e njohur ndërkombëtare të quajtur “Modeli i Çmimit të Kapitalit të Aseteve” (CAPM). CAPM shpreh koston e pritur të ekuitetit si një normë pa rrezik ( $r_f$ ) plus premiumin e rrezikut të ekuitetit (ERP). Ne mund ta definojmë ERP si ndryshimin mes rrezikut të tregut të ekuitetit – d.m.th. kthimi i pritur nga tregu i zhvilluar mirë – dhe normën e kthimit pa rrezik, e që shprehet me formulën e paraqitur më poshtë:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Norma e ERP mvaret nga rreziku i investimit në një treg të një vendi të veçant.

Vlera e WACC-ut para tatimeve mund të llogaritet sipas formules në vijim:

$$WACC_{pre-tax} = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

Ku:

**D/V** Raporti i borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)

**E/V** Raporti i ekuitetit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)

<b>V</b>	Totali i bazës së kapitalit, që është shuma e ekuitetit dhe borxhit
<b>k<sub>d</sub></b>	Kostoja e Borxhit
<b>k<sub>e</sub></b>	Kostoja e ekuitetit

**Kostoja e borxhit (k<sub>d</sub>)** është zotim kontraktual dhe është norma që ndërmarrja paguan në huatë e marruna në të ardhmen, dhe shprehet sipas formules:

$$k_d = r_f + d_{rp}$$

Ku:

<b>r<sub>f</sub></b>	Norma pa rrezik
<b>d<sub>rp</sub></b>	Premiumi i rrezikut të borxhit

**Kostoja e ekuitetit (k<sub>e</sub>)** llogaritet si në vijim:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

Ku:

<b>r<sub>f</sub></b>	Norma pa rrezik dhe nxjerret nga vlerësimet për kthimin në obligacionet (“bondet”) e qeverisë
<b>β<sub>e</sub></b>	“Beta”: masa e rrezikur për kompaninë përkatëse
<b>(r<sub>m</sub> - r<sub>f</sub>)</b>	Premiumi i rrezikut të tregut të ekuitetit minus norma e kthimit pa rrezik

“Premiumi i rrezikut” është përcaktuar nga “beta” dhe nga premiumi i rrezikut të pritur të një tregu, e që investitorët e kërkojnë nga tregu si tërësi. Faktori “beta” matë pa-parashikueshmërinë e kthimit të një kompanie në relacion me tregun e mallrave (aksoneve) si tërësi.

Më poshtë ne vlerësojmë / llogarisim koston e borxhit dhe koston e ekuitetit për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë, për të ardhur tek WACC para tatimeve.

### **3.3.2.1 Kostoja e Borxhit**

Rezultatet e mëparshme për raportin e borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit për NQ “TERMOKOS” dhe NQ “GJAKOVA” gjatë sezonit të ngrohjes 2005-2006 janë bazuar nga të dhënat financiare që kemi marrë dhe definohet në 50% dhe 73% respektivisht.

Për këtë sezon të ngrohjes dhe ata vijues, ZRrE-ja ka vendosur që raporti D/V të jetë në mes të 50% dhe 73% dhe e vendos ne vlerën 60/100 (60% borxh dhe 40% ekuitet). Ky raport 60% duhet të përdoret në vlerësimet / llogaritjet e WACC-ut komercial para tatimeve për kompanitë e ngrohjes qendrore në Kosovë.

Kthimi në borxh paraqitet sipas formulës më poshtë:

$$k_d = r_f + d_{rp}$$

Ku:

<b>r<sub>f</sub></b>	Norma pa rrezik
<b>d<sub>rp</sub></b>	premiumi i rrezikut të borxhit

Sa i përket normës pa rrezik të borxhit ( $d_f$ ) ne supozojmë se nëse qeveria e Kosovës do të emitonte obligacione (bonde), fillimisht do kishte normën e interesit më të ulët se sa të investimeve. Ne supozojmë se kjo do rangohej më poshtë se Ukraina dhe Turqij, që të dyja kanë rangimin e kreditit BB-. Pra duket e arsyeshme që të marrim për Kosovën një **normë reale pa rrezik të borxhit 5.5%**, që është mes mesatares së Ukrainës dhe Turqisë, dhe asaj të Argjentinës.

Nga disa shembuj të Autoriteteve rregullative të BE dhe Australisë, premiumi i rrezikut të borxhit ( $d_p$ ) vlerësohet në rangun prej 0.84 dhe 1.75%. Duke marrë parasysh rrezikun e lartë për shkak të mos-pagesës bashkë me performancën ekonomike të dobët të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në Kosovë, ne e vlersojmë  $d_p$  për Kosovë më lartë dhe e vendosim në **2.5%**.

Kostoja e borxhit pastaj llogaritet si më poshtë:

$$k_d = 5.5\% + 2.5\% = 8\%$$

### 3.3.2.2 Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e ekuitetit paraqitet me formulën më poshtë:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Vendimet e fundit të autoriteteve rregullative e vlerësojnë premiumin e rrezikut në ekuitet në rangun prej 3.5 gjer 7%, me një mesatare prej 5.0%. Ne propozojmë të merret **ERP-ja për Kosovë e barabartë me 6%**.

Beta mesatare e asetëve për rrjetet e energjisë elektrike në BE dhe për ndërmarrjet e integruara është 0.42 e krahasuar me 0.54 - 0.63 për ndërmarrjet që kanë vetëm gjenerimin dhe furnizimin në BE dhe SHBA. Për shkak se industria e ngrohjes qendrore në Kosovë është e vogël, duket e arsyeshme që të supozojmë se rritja e kërkesës – që është faktori kryesor për rritjen e të ardhurave – do të jetë më e pa-parashikueshme se sa rritja e GDP – që është faktori kryesor për rritjen e tregut të mallrave dhe akcioneve – se sa në vendet e mëdhaja dhe të zhvilluara. Shtimi i një konsumatori të vetëm të madhë në ngrohjen qendrore do të thotë rritjen e kërkesës për ngrohje qendrore në krahasim me kërkesën e mëparme, përderisa ndikim në GDP mund të jetë shumë më i vogël. Në mënyrë që ta marrim në konsideratë natyrën më të pa-parashikueshme të të ardhurave të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në krahasim me rritjen e GDP, ne vlersojmë që kostoja e ekuitetit të jetë më e lartë se sa mesatarja e vendosur nga rregullatorët e BE-së, dhe ne konsiderojmë se “ $\beta_e$ ” e arsyeshme për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë si më poshtë:

$$\beta_e = 1$$

Kostoja e ekuitetit pas tatimeve është si në vijim:

$$k_{e \text{ post tax}} = 5.5\% + (1 * 6\%) = 11.5\%$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve gjindet duke shumëzuar rezultatin më lartë të kostos së ekuitetit pas tatimeve me relacionin që e konsideron tatimin (“tax wedge”) si më poshtë:

$$\text{Tax wedge} = 1/(1-t)$$

ku:

**t** Shkalla e tatimit në fitimin e kompanive

Tatimi në fitim (t) në Kosovë është 20% dhe relacioni që e konsideron tatimin (“tax wedge”) është:

$$1/(1-0.20) = 1.25$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve është:

$$k_{e \text{ pre-tax}} = 11.5\% * 1.25 = 14.4\%$$

Si rrejdhim i llogarive më lartë llogaritet WACC-u para tatimeve – i rrumbullaksuar në një decimale – si më poshtë:

$$\text{WACC}_{\text{pre-tax}} = [8\% * 0.6] + [14.4\% * 0.4] = 10.6\%$$

### 3.3.3 Llogaritja e Kthimit të Lejuar në RAB (Profiti të Lejuar) për NQ GJAKOVA

Bazuar në  $\text{WACC}_{\text{pre-tax}}$  e llogaritur prej 10.6% si në 3.3.2, ne jemi në gjendje të llogarisim Kthimin e Lejuar apo Profitin e Lejuar për NQ GJAKOVA, i cili sipas formulës më poshtë:

**(RoR x RAB pëfundimtarë)**

Është i barabartë me €2,114,491 \* 10.6% = €224,136.

**Tabela 3: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB për NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008**

		Në €	
	Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB për NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008	Propozuar nga DH /NQ GJAKOVA	Allowed by ERO Lejuar nga ZRrE
<b>CLOSING RAB</b>	<b>Baza e Rregulluar e Aseteve</b>	<b>3,433,000</b>	<b>2,114,491</b>
<b>RoR</b>	<b>Norma e Kthimit në vlerën e WACC</b>	<b>10.6 %</b>	<b>10.6 %</b>
	<b>Kthimi i Lejuar ose Profiti i Lejuar</b>	<b>363,898</b>	<b>224,136</b>

### 3.4 Llogaritja e të Ardhurave të Lejuara para Bashkëndimit

Të Ardhurat e lejuara totale para bashkëndimit janë llogaritur sipas formulës:

$$R_{bRec} = OC + Zhvlerësimi Vjetor + Kthimi i Lejuar në RAB,$$

dhe është e barabartë me €911,354, siq paraqitet detalisht në Tabelën 4.

**Tabela 4: Kthimi i Lejuar para Bashkëndimit për sezonin e ngrohjes 2007/08**

Në €

Të Ardhurat e Lejuara para Bashkëndimit NQ GJAKOVA për sezonin 2007 – 2008		Proposed by DH GJAKOVA	Allowed by ERO
OC	Kostot Operacionale të Lejuara	562,920	496,670
	Zhvlerësimi	280,000	190,548
	Kthimi i Lejuar në RAB (Profiti Lejuar)	363,898	224,136
<b>R<sub>bRec</sub></b>	<b>Të Ardhurat Lejuara para Bashkëndimit</b>	<b>1,206,818</b>	<b>911,354</b>

### 3.5 Bashkëndimi i të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2006-2007

Bazuar në Bashkëndimin e llogaritur nga ZRrE-ja siq është dhënë në “Vlerësimi I Raportimit Rregullativ të Ngrohtores së Qytetit GJAKOVA SH.A. - Krahasimi I të dhënave aktuale për sezonin e ngrohjes 2006/2007” të nxjerrur në shtator, që në fakt është ndryshimi I pranuar nga ZRrE-ja në mes të të Ardhurave të Lejuara aktuale dhe të planifikuara të NQ Gjakovës për sezonin e ngrohjes 2006-2007, €28,310 do të zbriten nga të Ardhurat e Lejuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008.

### 3.6 Llogaritja Finale e të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008 përfshirë bashkëndimin e sezonit të ngrohjes 2006-2007

Të ardhurat e Lejuara janë llogaritur sipas formulës në vijim:

$$R = R_{bRec} +/- Vlera e Bashkëndimit$$

Pra përfundimisht, Të Ardhurat e Lejuara për NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007-2008 janë përcaktuar në vlerën €883,044, siq është përmbledhur në Tabelën 5.

**Tabela 5: Të Ardhurat e Lejuara për NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007-2008**

Në €

<b>Të Ardhurat e Lejuara – NQ GJAKOVA për sezonin e ngrohjes 2007 – 2008</b>		<b>Lejuar nga ZRrE</b>
<b>R<sub>bRec</sub></b>	<b>Të Ardhurat e Lejuara para Bashkërendimit</b>	<b>911,354</b>
	<b>Bashkërendimi – sezoni ngrohjes 2006-2007</b>	<b>-28,310</b>
<b>R</b>	<b>Të Ardhurat e Lejuara</b>	<b>883,044</b>

Në përputhje me proporcionin e kostove operacionale fikse dhe variabile para subvencioneve – që është €165,050 respektivisht €681,620 – përqindja e pjesës fikse është **19.50%** dhe përqindja e pjesës variabile është **80.50%**. Ndarja e të Ardhurave të Lejuara në pjesën fikse dhe variabile është si vijon:

**Pjesa fikse e të Ardhurave të Lejuara (R<sub>F</sub>)** €172,141; dhe

**Pjesa variabile e të Ardhurave të Lejuara (R<sub>V</sub>)** €710,903.